



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 545/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Deçan dhe Vushtrri, dhe kandidatët për asamble komunale të subjektit politik LDK, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan, dhe Komisionarëve të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, për shkak të shpërndarjes së materialit propagandistik në Vendvotime VV, pengim gjatë procesit të votimit si dhe manipulim i votave, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Deçan dhe Vushtrri: Anr.545/2013, Anr.549/2013, Anr.564/2013, Anr.565/2013, Anr.566/2013, Anr.567/2013, Anr.568/2013, Anr.569/2013, Anr.570/2013, Anr.571/2013, Anr.572/2013.

Arsyetim

PZAP, më datë 04.11.2013, ka pranuar 11 (njëmbëdhjetë) ankesa: Anr.545/2013, Anr.549/2013, Anr.564/2013, Anr.565/2013, Anr.566/2013, Anr.567/2013, Anr.568/2013 dhe Anr.569/2013, Anr.570/2013, Anr.571/2013, dhe Anr.572/2013, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe kandidatët për asamble nga subjekti politik LDK, për shkak të shpërndarjes së materialit propagandistik në Vendvotime VV, pengim gjatë procesit të votimit si dhe manipulim i votave, në Zgjedhjet Lokale, të 3 Nëntorit 2013.

- Në ankesën Anr.545/2013, pretendohet se Mustafë Hasanaj, në cilësinë e kandidatit të subjektit politik AAK, se me datë 03.11.2013, rreth orës 13:45, në Qendrën e Votimit QV Nr. 0105C, në fshatin Strelle i Epërm në Shkollën

Filllore "Bajram Curri", ka shpërndarë material propagandistik të AAK, dhe shenja dalluese, duke bërë thirrje për votim të AAK-së, dhe të atij personalisht.

- Në ankesën Anr.549/2013, pretendohet se me datën 03.11.2013, në ora 12:50 në Qendrën e Votimit në fshatin Isniq të Komunës së Deçanit, zyrtarët e subjektit politik AAK, pengojnë procesin e votimit. Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e LZP-së, përkatësisht neni 34.
- Në ankesën Anr.564/2013, Shkëlzen Xhaferi pretendon se i janë vjedhur votat nga komisionarët e LDK-së, gjatë numërimit në QV 2701/b/07/. Parashtruesi i ankesës i ka cekur vetëm dy emra në cilësinë e dëshmitarit, Dafina Musa dhe Artina Musa.
- Në ankesën Anr.565/2013, Gentiana Rama pretendon se i janë vjedhur votat nga komisionarët e LDK-së. Parashtruesi i ankesës e ka cekur vetëm një emër në cilësinë e dëshmitarit, Tefik Pronaj.
- Në ankesën Anr.566/2013, Gentiana Rama pretendon se janë vjedhur votat brenda partisë nga komisionarët e LDK-së. Në cilësinë e dëshmitarit ceket personi me emër Lumni Isufi.
- Në ankesën Anr.567/2013, Gentiana Rama pretendon se në Vendvotimin ku ka punuar komisioneri i subjektit politik LDK, është bërë vjedhje e votave brenda subjektit politik. Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitarit ceket emrin e personit Adem Bala.
- Në ankesën Anr.568/201, Besim Parduzi pretendon se në Vendvotimin 2712b/03/6, komisioneri i LDK-së, ka bërë vjedhje të votës brenda subjektit politik. Në cilësinë e dëshmitarit ceket personi me emër Ferki Perquku.
- Në ankesën Anr.569/2013, Shkëlzen Xhaferi pretendon se i janë vjedhur votat në VV 2702/b/03/, nga komisioneri i LDK-së. Në cilësinë e dëshmitarit ka të cekur personat me emrin Medina Gërxhaliu, dhe Mirlinda Gërxhaliu.
- Në ankesën Anr.570/2013, Shkëlzen Xhaferi, pretendon se i janë vjedhur votat gjatë numërimit për asamble komunale nga komisioneri i LDK-së, në VV 2710/b/01/. Në cilësinë e dëshmitarit ka të cekur personat me emër Saranda Cakaj dhe Eranda Cakaj.
- Në ankesën Anr.571/2013, Shkëlzen Xhaferi, pretendon se i janë vjedhur votat në VV 2727/b/01/, nga komisioneri i LDK-së, gjatë numërimit për asamble komunale. Në cilësinë e dëshmitarit ka të cekur personat me emër Baki Kuqi dhe Agron Kuqi.
- Si dhe në Anr.572/2013, po ashtu Shkëlzen Xhaferi pretendon se i janë vjedhur votat në VV 2702/x/01, nga komisioneri i LDK-së, gjatë numërimit.

Parashtruesi i ankesës ka cekur në cilësinë e dëshmitarit personin Xhemshit Musa.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajtojë si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara

Pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Deçan ndaj subjektit politik AAK, se kandidati i këtij subjekti Mustafë Hasanaj në fshatin Strelle i Epërm, ka shpërndarë material propagandistik të AAK-së në QV, ndërsa në Isniq zyrtarët e AAK kanë penguar procesin e votimit, si dhe pretendimet e kandidatëve për asamble komunale nga subjekti politik LDK, dega Vushtrri, se nga komisioneret e LDK-së janë vjedhur votat gjatë numërimit për asamble komunale, nga komisionerë të LDK-së, në VV e lartcekura, janë të pabazuara, nga shkak se nga parashtruesit e ankesës, përveç të disa emrave të personave në cilësinë e dëshmitarit, për të cilët nuk është ofruar asnjë informacion në bazë të nenit 3.6 pika f) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, nuk është bashkangjitur asnjë provë ankesave të parashtruara, me anë të cilave do të mund të verifikoheshin shkeljet e pretenduara,

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar parregullsi në VV e lartpërmendura nga parashtruesit e ankesës, PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 545/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xheydet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*